

detyrë projektimi

për objektin:

Rikonstruksion Rruga Selim Gjyrezi

Bashkia Shkodër, me fondin e vënë në dispozicion nga të ardhurat e saj, kërkon të realizojë projektin për objektin: Rikonstruksion Rruga Selim Gjyrezi

1. TË DHËNA DHE KËRKËSA TË PËRGJITHSHME

1.1. Të dhëna të përgjithshme

- *Objekti:* Rikonstruksion Rruga Selim Gjyrezi
- *Vendndodhja:* Bashkia Shkodër, Lagje 1
- *Pozicioni gjeografik:* Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në rrugën Selim Gjyrezi që kufizohet me rrugën Lamijë në Jug dhe rrugën Selim Çoba në Veri dhe ndodhet në Lagjen 1. Kjo rrugë shërben kryesisht për banesa 1-3 kate, me gjatësi 120 m dhe sipërfaqe 600 m². Kjo rrugë i shërben rreth 10 familjeve dhe jo vetëm.
- *Koordinatat janë:* KRGJSH 458494.115;4660535.924
- *Sipërfaqja totale:* 600 m²

1.2. Objektivi i projektit

Qëllimi i projektit konsiston në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe sigurisë publike, përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe në mënyrë të veçantë të ofrimit të një rruge me standartet e duhura në shërbim të komunitetit.

Me zbatimin e këtij projekti do të përfitohen rreth:

600 m² sipërfaqe rruge e rikualifikuar/asfaltuar; Sinjalistikë e plotë për lëvizshmërinë;
40 banorë përfitojnë.



2. GJENDJA EKZISTUESE

2.1. Infrastruktura rrugore ekzistuese

Rrugët që përshkojnë këtë zonë janë në gjendje shumë të keqe. Ato kanë bazament, nuk kanë kullim të mirë, me gropa dhe të vështira për t'u përshkuar. Rikonstrukcion Rruga Selim Gjyrezi është projekt për rehabilitimin dhe kthimin në standart të mirë të rreth 120 m linear rrugësh, me gjerësi që varion nga 4.5 m – 5.5 m.

Ky projekt parashikon ndërtimin e elementeve të nevojshëm për krijimin e kushteve optimale në shërbim të komunitetit.

2.2 Kanalizimet ekzistuese të ujërave të zeza

Në këtë segment nuk ekziston rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza.

2.3 Kanalizimet ekzistuese të ujërave të bardha

Rruga nuk evadon në mënyrën e duhur ujerat atmosferik.

2.4 Rrjeti ekzistues i ujësjellësit

Për rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm të verifikohet gjendja e tij.

2.5 Rrjeti ekzistues i ndriçimit rrugor

Rrjeti i ndriçimit rrugor nuk ekziston.

2.6 Rrjeti ekzistues i furnizimit me energji elektrike dhe i telekomunikacionit

Linjat e energjisë elektrike janë të padisiplinuara dhe kalojnë mbi trupin e rrugës.

2.7 Sinjalistika ekzistuese

Sinjalistika nuk ekziston

Projektuesi ka për detyrë që:

përpara se të fillojë punën për realizimin e projektit,

- të bëjë rilevimin e rrugës

- të marrë të gjitha azhurnimet e rrjetit të infrastrukturës. Të dhënat e nevojshme për projektim siç janë gjendja ekzistuese e kanalizimeve (përfshirë pikat përkatëse të lidhjes), ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, rrjeti i telefonisë do të merren te institucionet përkatëse nga projektuesi.
- të bëjë verifikimin paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektimit që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit.
- të bëjë matjen e trafikut ekzistues dhe atë të parashikuar që këto të dhëna të përcaktojnë paketën e shtresave që do të aplikohet.

3 KËRKESAT E PROJEKTIT

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë:

- Infrastrukturën rrugore
- Sistemin kanalizimeve të ujërave të zeza
- Sistemin kanalizimeve të ujërave të bardha
- Rrjetin e ujësjellësit
- Sistemin e ndriçimit rrugor
- Rrjetin e furnizimit me energji elektrike dhe rrjetin e telekomunikacionit (nuk parashikohet ndërhyrje)
- Rrjetin e sinjalistikës

3.1 Infrastruktura rrugore

Do të hartohet projekti dhe preventivi për fazën e zbatimit, shoqëruar me specifikimet teknike përkatëse, për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha, tombinove dhe i linjave të reja të nevojshme sekondare ose kolektorë në përputhje me planin urbanistik të përgatitur nga Bashkia dhe në konformitet me kërkesat e veçanta për rritjen e kanalizimeve të përshkruara në këtë detyrë projektimi. Shtresat duhet të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektives. Materialet që do përdoren të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve.

3.2 Kanalizimet e ujërave të zeza

Të bëhet azhurnimi në terren i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, nëse ka, në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera.

3.3 Kanalizimet e ujërave të bardha

Të projektohet rrjeti i KUB në varësi të reshjeve të zonës dhe të jepet zgjidhja optimale sipas manualit teknik ose në përputhje me kërkesat e Bashkisë Shkodër.

3.4 Rrjeti i ujësjellësit

Të bëhet azhurnimi në terren i rrjetit të ujësjellësit, nëse ka, në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera.

3.5 Sistemi i ndriçimit rrugor

Të kryhen azhurnimet në terren, nëse ka pjesë në funksion, në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera.

3.6 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe rrjeti i telekomunikacionit

Të kryhen azhurnimet në terren, nëse ka pjesë në funksion, në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera.

3.7 Rrjeti i sinjalistikës

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Pranë kryqëzimeve të vendosen shtylla njoftuese për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës.

Kosto e projektit - Hartimi i preventivit të veprës për projektin e zbatimit

Kosto totale e ndërhyrjes do të jepet nga preventivi përfundimtar i objektit. Vlera limit e parashikuar për zbatimin të projektit është **5,610,000** lekë me T.V.SH. Kostoja do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimet teknike, duke marrë parasysh edhe kërkesa të veçanta të Bashkisë Shkodër në lidhje me standardet e pranura dhe me çmimet për njësi sipas manualit teknik të çmimeve me V.K.M. nr. 629, datë 15.07.2015.

Nëse vllera përfundimtare e tejkalon fondin limit të parashikuar, **i gjithë dokumentacioni i projektit do të dorëzohet i ndarë në dy faza**, sipas gjykimit të projektuesit dhe me dakordësinë e Bashkisë Shkodër. ku **faza I të mos tejkaloje vlerën 5,610,000 Lekë me T.V.SH.**

4 REALIZIMI I PROJEKTIT

4.1 FAZA I - Projekt-ideja

Paraqitja e varianteve të ndërhyrjes në bazë të rezultatit të vlerësimit ekonomiko-financiar, skemës së qarkullimit, bazuar në studimet e miratuara në organet kompetente. Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake dhe volumet e shpronësimeve nëse ka për çdo variant.

Pas realizimit të projekt-idesë, projektuesi duhet të marrë miratimin nga Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Projekteve për variantin e projektit të zbatimit. **Në çdo rast, projekt-ideja dhe miratimi i saj duhet të jepen jo më vonë se gjysma e afatit të kontratës**

4.2 FAZA II - Projekt-zbatimi

Të kryhet hartimi i Projektit “Rikonstruksion Rruga Selim Gjyrezi”, i cili duhet të përmbajë:

- Raporti teknik
- Preventivi i kryerjes së punimeve, duke u mbështetur në çmimet e miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, ose mbi çmime të shoqëruar me analiza përkatëse.
- Specifikimet teknike të zbatimit të projektit
- Grafiku i punimeve
- Paraqitja grafike e projektit

Preventivi përfundimtar dhe të paktën 70% e materialit grafik duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve jo më vonë se 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të kontratës

4.2.1 Llogaritjet, specifikimet teknike, raporti teknik, grafiku i punimeve dhe preventivi

Projekt zbatimi do të shoqërohet me llogaritjet përkatëse duke u bazuar në standardet shqiptare apo ndërkombëtare. Pjesë e projekt-zbatimit do të jenë raporti teknik, grafiku i punimeve, specifikimet teknike dhe preventivi me çmime të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015.

4.2.2 Paraqitja grafike e projektit

Projekt-zbatimi duhet të përmbajë minimumi fletët si më poshtë:

- a. Topografinë e gjendjes ekzistuese për zonën që zbatohet projekti në të cilën janë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) me Koordinata dhe përmasat përkatëse
- b. Planimetria shpronësimeve nqs ka SH 1:1000
- c. Planimetria e përgjithshme dhe relievi i zonës në SH 1:1000
- d. Planimetritë e përmasuara të sheshit në SH 1:500, 1:200
- e. Planimetritë teknike SHK. 1:100, V 1:200
- f. Profilet tërthore dhe gjatësore të rrugëve jo më rrallë se 25 m, si dhe vende me karakteristika të veçanta SH 1:100
- g. Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, trotuareve, pusetave, etj., SH 1:20, 1:50.
- h. Planimetri për kryqëzimet dhe detaje përkatëse SH 1:200
- i. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën 1:500
- j. Profilet gjatësore të rrjetit të kanalizimeve në SH. H 1:1000, V 1:100
- k. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve
- l. Grafiku i punimeve

4.3 Raportimi

I gjithë projekti do të paraqitet në 4 kopje të printuara;

- ne format A3 Paraqitja grafike e projektit
- në format A4 relacioni teknik, llogaritjet, specifikimet teknike, grafiku i punimeve dhe preventivi me dhe pa çmime

Projekti do të dorëzohet në 4 kopje të printuara dhe 2 kopje CD në versionin të dixhitalizuar, ku një CD do të përmbajë punimet në DWG, Office Word-Excel, dhe një CD do të përmbajë të gjithë dokumentacionin në format PDF .

I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht sipas kërkesave për pajisje me leje ndërtimi të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 ”Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“, të ndryshuar me VKM Nr. 271, datë 6.4.2016.

5 STANDARTET

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit.

Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja për përcaktimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktiken shqiptare dhe Iimitimet për financimin e veprës,

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt duhet të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këto kategori. Detajet për këtë kategori të jepen në fletë të veçanta.

5.1 Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Rekomandime për projektuesin:

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me rrugën që do të rikonstruktohet.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe nga Hipoteka. Në hartimin e projektit duhet të merren parasysh dhe standarte të tjera të nxjerra nga Bashkia Shkodër
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar.